



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.645/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar kolegji, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Auto Taxi B.K. me seli në Prizren të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Visar Ostrozubi avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve SIGMA nga Prishtina, të cilën e përfaqëson me autorizim Bali Mahmuti avokat nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesat e paditësit dhe të paditurit të parashtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.1035/22 të datës 21.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 11.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Auto Taxi B.K. me seli në Prizren, dhe ankesa e paditurës Kompania e Sigurimeve SIGMA nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KE.nr.1035/22 i datës 21.11.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar KE.nr.10335/2 i dates 21.11.2023, gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si ne vijim: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Auto Taxi B.K. me seli në Prizren, dhe Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve SIGMA, që në emër të dëmit material si pasoje e dëmneve të shkaktuara në aksidentin e datës 15.09.2012, t,ia paguaj paditësit shumën prej 6,227.90Euro, dhe në emër të fitimit të humbur shumen prej 843,73Euro, me kamatë ligjore në lartësi prej 12% të interesit vjetor, nga data e paraqitjes së padisë 15.09.2012 e deri në pagesën definitive, në afaty prtej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcnim të përmbarrimit, II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit Auto Taxi B.K., përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë për shumën prej 2,669.10Euro, në emër të kompensimit të dëmit dhe shumën prej 361.63Euro në emër të fitimit të humbur, III. Detyrohet e paditura që paditësit t,ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 2,977.94Euro, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor kanë paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit dhe i padituri.

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar konteston aktgjykimin e atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe të aprovohet në tërsi kërkesëpadia e paditësit si e bazuar e precizuar në parashtresën e datës 24.06.2014, Të ndryshohet dispozitivi i aktgjykimin të ankimuar në pikën III sa i përket shpenzimeve procedurale duke u obliguar e paditura që të kompensoj në tërsi shumën në emër të shpenzimeve procedurale në shumën prej 5,431.00Euro.

I padituri e kundërshton me ankesë aktgjykimin e atakuar për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu që kamatën të gjykohej në lartësi siq e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë, si për mjetet e afatizuara mbi 12 muaj pa destinim të caktuar, ose aktgjykimin e ankimuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

I padituri ka paraqitë përgjigje ndaj ankesës së paditësit me propozimin që gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj ankesën e paditësit ndërkaq ankesën e të paditurit ta aprovoj si të bazuar.

Dhoma e Shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Auto Taxi B.K. me seli në Prizren, me datën 04.04.2013 ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve SIGMA nga Prishtina, për kompensimin e dëmit, nga dëmi i shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit datës 15.09.2012, me kamatë ligjore në lartësi prej 12% të interesit vjetor duke filluar nga data e aksidentit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore kundër të paditurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar në rigjykim, pas administrimit të provave në seancën e shqyrtimit kryesor datës 21.11.2023, ka nxjerr aktgjykimin e atakuar me të cilin ka Aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin. Në arsyetim të aktgjykimin gjykata thekson se gjendja faktike e vërtetuar nga konstatimet e ekspertëve të komunikacionit vlerëson se përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve si pasojë e aksidentit të komunikacionit është e ndarë dhe se të paditurit i takon përgjegjësia për 70% e kompensimit të dëmit, meqenëse nga lëshimet e të siguruarit të paditurit ka ardhur deri te aksidenti i komunikacionit, te cilave ekspertiza gjykata iu fali besimin. Në këtë rast kontribut sekondar në shkaktimin e dëmit material ka dhënë edhe ngasësi i veturës VW Polo me targa ... me drejtues V.M. i cili ka qenë i siguruar tek KS SIGAL. Gjithashtu në bazë të konstatimeve të ekspertit Y.K. në lartësinë e dëmit dhe ekspertizës financiare të A.K.sa i përket fitimit të humbur të paditësit, gjykata në bazë të përgjegjësisë së ndarë vlerëson se paditësit i takon shumën në emër të dëmit prej 6,227.90Euro dhe

fitimi i humbur shuma prej 843.73Euro. Gjykata vlerësimin e ka bërë bazuar ne dispozitat e nenit 189 të LMD-së. Gjykata referohet ne nenin 26 pika 6 e Ligjit per Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto përgjegjësia, duke e detyruar të paditurin që paditësit t,ia paguaj kamatën ligjore prej 12% në vit duke filluar nga data 15.09.2012 e deri në pagesën defintive.

Dhoma e shkalles së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2 të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 178 të Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), në të cilin është përcaktuar: *Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesiseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullate mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë. Në qoftë se ekziston faji dypalësh, secili zotërues përgjigjet për dëmin total që e kanë pësuar ata përpjestimisht me shkallën e fajësisë së tyre. Në qoftë se nuk ka fajsi në asnjë anë zotëruesit përgjigjen në pjesë të barabarta në qoftë se shkaqet e drejtërisë nuk kërkojnë gjë tjetër. Për dëmin që e kanë pësuar personat e tretë zotëruesit e automjeteve përgjigjen solidarisht.*

Në rastin konkret nga shkresat e lëndës respektivisht nga provat e administruara rezulton se me datë 15.09.2012 ne magjistralen Prizren-Prishtinë, ka ndodhur aksidenti i siguruar në komunikacion, duke iu shkaktuar dëm material veturës së paditësit. Kolegji i Dhomës se shkallës së dytë nga shkresat e lëndës respektivisht ekspertizat e komunikacionit nga S.B. dhe grupi eksperteve dt.25.10.2023, knstqaton se aksidenti i komunikacionit rrugor ka ardhur nga lëshimet e drejtuesit te automjetit A, automjetit transportues me targa ... me drejtues M.L., si shkaktar i aksidentit, i cili duke kaluar në shiritin e kahjes se kundërt, me pjesën anësore të majtë rimorkios e godet automjetin B me targa ... me drejtues B.K.. Gjithashtu këtij aksidenti i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit C me targa ... me drejtues V.M., i cili nuk ka arrit që ta ndal automjetin, ku me pjesën e përparme godet automjetin B.

Nga kjo gjendje faktike që ka rezultuar sa i përket përgjegjësisë së dëmit të shkaktuar ndaj paditësit, nga aksidenti i komunikacionit dt.15.09.2012, Kolegji vlerësoi se me te drejt gjykata e shkallës së parë, ka konstatuar se të paditurit i takon përgjegjësia për shkaktimin e dëmeve si pasoj e aksidentit për 70% të kompensimit të dëmit, duke marrë në konsideratë që nga kjo përgjegjësi e të siguruarit të paditurit, të zbatohet edhe kompensimi në lartësinë e dëmit dhe fitimit të humbur, pra sipas përgjegjësisë së ndarë.

Dhoma e shkallës së dytë nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet ankimore të paditësit se Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK-së, se gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të gabuar gjendjen faktike sa i përket vendimit për kompensimin e dëmit sipas shumës së gjykuar. Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me ndonjë shkelje që do të kishte ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike. Dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e shkallës së dytë. Kolegji nuk i vlerësoi të gabuara pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka gjykuar vendimin mbi kompensimin e dëmit, ngase në aksidentin e komunikacionit dt,15.09.2012 grupi i eksperteve ka nxjerr konstatimin e përgjegjësisë edhe të palës së trete në këtë rast drejtuesi i veturës “C” e cila ka kontribuar në aksident.

Kolegji vlerësoi edhe pretendimet ankimore të paditurit sa i përket zbatimit të gabuar të drejtës materiale respektivisht pretendimit se lartësia e kamatës është dashtë të gjykohet konform Mendimit juridik të Gjykatës Supreme dt.20.12.2012, mirëpo bazuar në Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës dt.02.12.2020, Pjesa e Dytë, (Përfshirjet), XII, Kërkesat e palëve të treta ndaj kompanive të sigurimit. Kolegji vlerësoi se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kamatës ligjore prej 12% të interesit vjetor, sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës të shkallës së parë, nuk ka të meta për shkak të se cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, se aktgjykimi përmbanë arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së dytë

K.DH.SH.II.nr.645/24 datë 11.07.2024

Kryetari i Kolegjit – Gjyqtari
Krenar Berisha